

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“KASTRELI GAZ“ SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 15.08.2022, unë i nënshkruari:

1. **Aurrel Hoxha**, i datëlindjes 25.08.1972, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me numër identifikimi H20825052C

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

“KASTRELI GAZ“ SHPK

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 2: Selia

Lagjja 17, Spitallë, Kryqëzimi i Rrugës Vllazërimi dhe Juba, Zona Kadastrale 8517, Nr.Pasurie 158/38, Durrës.

Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Importi – eksporti, depozitimi, tregtimi, transformimi, transporti i gazit të lëngshëm të naftës (GLN), gazit propan, gazit metan, pjesëve përbërëse ose

përzierësve të tyre si dhe të gjitha llojeve të tjera të gazrave teknike për përdorim industrial dhe civil.

- Importi – eksporti, shitja e bombolave të gazit të të gjitha dimensioneve dhe për të gjitha përdorimet. Tregtimi dhe rimbushja e bombolave të gazit. Importi-eksporti, shitja me shumicë i karburanteve dhe produkteve e derivate të tyre si nafta, benzina, karburanti i përdorur në aviacion, vajra, lubrifikant, solari, etj përfshirë dhe biokarburantet dhe nënproduktet e këtyre të fundit. Shoqëria mund të zhvillojë gjithashtu çdo aktivitet tjetër plotësues e ndihmës që rezulton i dobishëm dhe/ose i nevojshëm për përmbushjen e objektit kryesor, duke përfshirë tregtimin e produkteve dhe kryerjen e shërbimeve të tjera.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt.14.04.08).

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është **100.000 (njëqindmijë)** Lekë, i ndarë në 1 kuotë.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Aurrel Hoxha, është zotërues e 1 kuote, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 100.000 lekë.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Aurrel Hoxha**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

Aurrel Hoxha

